



PËRFSHIRJA E STUDENTËVE TË KOMUNITETEVE JO-SHUMICË NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

botues:

ADMOVEVERE

(drejtësi transicionale | edukim | paqëndërtim)

<http://admovere.org/>

ky raport u hartua nga:

Fitore Metbala

Aulonë Memeti

hulumtues:

Fitore Metbala

Aulonë Memeti

recensent:

Shkëlzen Gashi

dizajni i kopertinës dhe faqosja:

Think B

shtypi:

VM3

dhjetor 2020

Prishtinë

tirazhi:

300 kopje

hulumtimi dhe botimi u përkrahën nga:

KFOS (Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur)

ADMOVEVERE është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet (KITU), të mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të OJQ-së ADMOVEVERE dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), të KITU-së, e as të recensentëve.

ADMOVEVERE (drejtësi transicionale | edukim | paqëndërtim) angazhohet për ndërtimin e një shoqërie demokratike, promovimin e tolerancës e të bashkëjetesës dhe luftimin e paragjytimeve; dialogun mes komuniteteve të ndara për t'i tejkaluar mosmarrëveshjet, si dhe promovimin e praktikave të mira për drejtësi dhe pajtim. Fushat kryesore të organizatës janë të drejtat e njeriut, me theks të veçantë të drejtësia transicionale, edukimi dhe ndërtimi i paqes. Për më shumë: <http://admovere.org/>

PËRMBAJTJA

02 Shkurtesat

03 Falënderimet

04 Përmbledhje Ekzekutive

05 Analiza Ligjore

09 Fakultetet

Fakulteti i Arteve

Fakulteti i Bujqësisë

Fakulteti i Edukimit

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit

Fakulteti i Ekonomisë

Fakulteti i Filologjisë

Fakulteti i Filozofisë

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Fakulteti Juridik

Fakulteti i Mjekësisë

Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore

31 Qëndrime të Institucioneve Relevante lidhur me Përfshirjen e

Studentëve të Komuniteteve në UP

35 Gjetjet

40 Referencat

SHKURTESAT

APRK – Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës

AKA – Agjencia e Kosovës për Akreditim

FShMN – Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore

FIM – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

FIEK – Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

FNA – Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

IAL – Institucionet e Arsimit të Lartë

KFOS – Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

KITU – Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet

MASh – Ministria e Arsimit dhe Shkencës

SEMS – Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Studentëve

SMIAL – Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë

SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar

ShBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

UA – Udhëzim Administrativ

UP – Universiteti i Prishtinës

QS – Qendra e Studentëve

FALËNDERIME

Falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan në këtë publikim përmes intervistave, ofrimit të të dhënave publike, ndarjes së informatave dhe bashkëpunimit. Në veçanti, falënderojmë Sekretarin e Universitetit të Prishtinës z. Esat Kelmendi për profesionalizmin dhe ndihmën e pakursyer përgjatë hulumtimit, Nazime Kelmendin, u.d. Drejtoreshë e Shërbimit për Studentë, për kohën dhe bashkëpunimin e shkëlqyer

Për realizimin e intervistave me njësitë akademike, falënderojmë dekanët që ishin në këto pozita në kohën e zhvillimit të intervistave: prof. dr. Tahir Arbnesi, dekan i Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore; prof. dr. Lindita Sejdiu-Rugova, dekane e Fakultetit të Filologjisë; prof. asoc. dr. Haxhi Gashi, dekan i Fakultetit Juridik; prof. dr.sc. Abdullah Zejnullahu, dekan i Fakultetit të Ndërtimtarisë; prof. dr.sc. Ahmet Shala, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike; prof. dr. Suzana Manxhuka-Kërliu, dekane e Fakultetit të Mjekësisë dhe prof. ass. Pranvera Breznica, prodekane; prof. asoc. Agim Selimi, dekan i Fakultetit të Arteve; prof. dr. Imer Rusinovci, u.d. dekan i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë; prof. asoc. dr. Musa Selimi, dekan i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe të Sportit, dr.sc. Fevzi Berisha, dekan i Fakultetit të Arkitekturës, prof. ass. dr. Blerim Saqipi, Dekan i Fakultetit të Edukimit, si dhe prodekanen për çështje mësimore të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, znj. Mimoza Ibrani për intervistën dhe bashkëpunimin e mirë.

Falënderojmë për dërgimin e të dhënave të plota dhe korrektësinë prof. asoc. dr. Isak Shabani, dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, prof.dr. Violeta Nushi, dekane e Fakultetit të Arkitekturës, z. Miftar Shala, sekretar në Fakultetin Juridik; z. Besfort Krasniqi, sekretar në Fakultetin e Filologjisë; znj. Lumnije Ahmeti, sekretare në Fakultetin Filozofik; znj. Valbona Zhubi, sekretare në Fakultetin Ekonomik dhe z. Gani Ibrahim, sekretar në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sporteve. Po ashtu, falënderojmë zëvendës-ministrin Xhavit Rexhaj për intervistën dhe pritjen, si dhe Naim Gashin, Drejtor i Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Në fund, falënderojmë Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) për mbështetjen financiare për hulumtimin dhe publikimin e këtij raporti, Shkëlzen Gashin për komentet, vërejtjet dhe sugjerimet, Think B për dizajnin dhe faqosjen, si dhe VM3 për shtypin e këtij raporti.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Universiteti i Prishtinës zbaton kuotat për komunitetet jo-shumicë që nga viti 2004/2005. Megjithatë, ka pasur ankesa nga ana e studentëve të shumicës etnike për karriget e zbrazëta që i lë kuota prej 12%. Për vitin 2019/2020, Senati i UP-së ka vendosur që karriget e zbrazëta të rezervuara të mbushen me studentë shqiptarë. Në rrethana kur numri i rezervuar nuk mbushet nga studentët jo-shumicë, kuota, dukshëm nuk po e përmbush funksionin e saj. Po ashtu, ende nuk dihet se si është marrë vendimi për kuotën 12%, dhe se cili ka qenë efekti i saj, pasi që asnjëherë nuk është bërë analizë strategjike e as e trendeve të dala nga ajo.

Nga artikujt e gazetave dhe nga raportet e organizatave joqeveritare del se faktorët ekonomikë shpeshherë ndikojnë rëndë te komunitetet rom, ashkali e egjiptianë. Si pengesë përmendet edhe mungesa e njohjes së gjuhës shqipe te të rinjtë romë e boshnjakë, e ndonjëherë edhe turq, që duan të ndjekin studimet në UP. Për këtë arsye, apo edhe për mundësi më të mira studimore, të rinjtë turq shpesh shkojnë në Turqi për të studiuar. Te sërëbët, sipas raporteve të organizatave joqeveritare, pengesë për mos-përfshirje është refuzimi për të marrë pjesë në institucionet kosovare të arsimit, por edhe ekzistimi i "Universitetit të Prishtinës" në Mitrovicë Veriore.

Prandaj, qëllimi i këtij publikimi është që të ofrojë një pasqyrë të masave afirmative për komunitetet jo-shumicë dhe efektin e tyre ndër vite. Kjo pasqyrë do të përmbajë statistika bazike, një analizë të efekteve të masave afirmative të deritanishme në arsimin e lartë dhe propozime konkrete për rritjen e përfshirjes së komuniteteve jo-shumicë në UP (romë, ashkalinj, egjiptianë, goranë, sërëbë, boshnjakë dhe turq). Po ashtu, hulumtimi synon të tregojë se cili është efekti i kuotave dhe faktorëve të tjerë, siç janë njohja e gjuhës shqipe, kushtet e dobëta ekonomike dhe faktorë të tjerë në përfshirjen/mospërfshirjen e të rinjve të komuniteteve jo-shumicë në UP. Më konktetisht, do të sqarojë se çka tregojnë numrat e arsimit të komuniteteve në UP ndër vite, t'i shpjegojë shkaktarët e këtyre rezultateve, qofshin kushtet ekonomike, mungesa e njohjes së avancuar të shqipes apo mungesa e interesimit apo arsye krejt të tjera.

Për nevojat e këtij hulumtimi analizuam ligjet, rregulloret dhe vendimet relevante, pastaj kërkuam qasje në dokumente dhe të dhëna publike nga menaxhmentet e të gjitha njësive akademike të UP-së, si dhe nga rektorati dhe administrata qendrore. Tutje, zhvilluam takime dhe intervista me dekanët e fakulteteve të UP-së, me z. Xhavit Rexhaj, zëvendësministër i Arsimit dhe Shkencës (MASH), me z. Naim Gashi, Drejtor i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), e me radhë. Kufizimi kryesor gjatë këtij hulumtimi ishte mosofrimi i të dhënave nga disa njësi akademike të UP-së si dhe mospërgjigja e komisioneve parlamentare, gjegjësisht e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, në kërkesat tona.

E DREJTA E ARSIMIT NË KOSOVË

Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Institucionet publike e kanë obligim kushtetues të sigurojnë mundësi të barabarta për secilin, përfshirë këtu dhe aftësitë dhe nevojat e veçanta që mund të kenë¹. Meqenëse projekti ka për synim që të analizojë përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë në arsimin e lartë, rëndësi e veçantë i është kushtuar përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore që garantojnë të drejtat e komuniteteve. Qasja në arsim publik në të gjitha nivelet, hynë në kategorinë kushtetuese të të drejtave për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, kurse Ligji për Arsimin e Lartë, si objektiv e ka ofrimin e mundësive për të gjithë banorët e Kosovës që janë të aftë të përfitojnë nga ky arsim si dhe t'i kontribuojnë shoqërisë dhe vendit gjatë gjithë jetës. Garantimi i ofrimit të mundësive të barabarta pa asnjë lloj diskriminimi në bazë të racës, përkatësisë etnike e sociale ose përkatësisë së një komuniteti kombëtar e parasheh edhe Stauti i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishina"³. Është e qartë se asku jt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsim, këtë e përcakton edhe e drejta ndërkombëtare⁴, por në aspektin kombëtar, çfarë është përcaktuar e planifikuar për të drejtën në arsim si e drejtë kushtetuese?

Strategjitë

Ndër vite, përmes strategjive si dokumente orientuese, janë adresuar prioritetet dhe problematikat në vend. Strategjitë në vijim, janë analizuar për planifikimet lidhur me fushën e arsimit, e veçanërisht qasja e barabartë për komunitetet jo-shumicë:

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021

Kjo strategji është fokusuar më shumë në arsimin fillor dhe parauniversitar, duke u fokusuar në gjashtë pika: gjithëpërfshirje, përmirësim të cilësisë në arsimin parauniversitar, ndërlidhje sistem arsimor - treg i punës, forcim të funksioneve të provimit, inspektimit dhe akreditimit, si dhe optimizim të shpenzimeve e angazhim afatshkurtër të ekspertëve dhe studentëve nga diaspora.

Plani strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

Ky plan është përqëndruar në shtatë fusha tematike, e rrjedhimisht janë edhe shtatë objektiva strategjike. Synim i kësaj strategjie është rritja e pjesëmarrjes dhe qasja e barabartë në arsim. Objektiv i shtatë parasheh që të arrihet ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, krijimtarisë artistike, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021

Kjo strategji ka paraparë si objektiv dhe si rezultat të pritshëm përmirësimin e pjesëmarrjes në arsim të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali. Si aktivitet të veçantë ka paraparë zhvillimin e masave të veçanta pozitive dhe programeve përgatitore për regjistrim dhe mbajtjen e studentëve në IAL nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali. Këtë e parasheh të realizohet përmes:

¹Neni 4, paragrafet 1 dhe 2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

²Neni 59, paragrafi 2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës

³Neni 7, Statuti i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

⁴Neni 2, Protokollin Nr.1 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

- Sigurimit të kurseve intensive për kandidatët nga komunitetet për t'i përgatitur për provimin pranues;
- Politikës së vendeve të rezervuara në IAL derisa të arrihet pjesëmarrje e barabartë;
- Programeve për mbështetjen e studentëve për t'i mbajtur në arsimin e lartë studentët nga komunitetet dhe grupet e marginalizuara përmes mentorimit, sigurimit të transportit dhe konvikteve.

Kjo strategji synon përmirësim të pjesëmarrjes në arsim të pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe ashkali, përmirësim të performancës së nxënësve dhe studentëve të komuniteteve si dhe ndërgjegjësim të palëve të interesit për të ndihmuar arsimin e pjesëtarëve të komunitetit rom dhe ashkali.

Gjuha e studimeve

Pjesëtarët që u përkasin komuniteteve kanë të drejtë kushtetuese dhe ligjore që lirshëm dhe pa ndërhyrje të përdorin gjuhën e komunitetit të tyre në jetën private dhe publike në formë të folur dhe të shkruar⁵. Sa i përket përdorimit të gjuhëve në arsim, gjuhët zyrtare të Kosovës janë gjuhët parësore të mësimin në universitetet publike⁶. Universitetet përmes akteve të tyre caktojnë rregulla të përdorimit të gjuhëve zyrtare dhe çdo gjuhe tjetër në programet arsimore si dhe në administratën universitare⁷.

Ligjërisht Republika e Kosovës obligohet të garantojë mundësitë ekzistuese për trajnim profesional dhe shkollim të lartë në nivel universitar në gjuhët e komuniteteve. Por, duhet pasur parasysh që ofrimi i shkollimit të mëtutjeshëm të lartë dhe programe të trajnimit profesional në gjuhët e komuniteteve, do të bëhen në pajtim me nevojën e shprehur si dhe me mundësitë financiare⁸. Arsimimi i komuniteteve zhvillohet në pajtim me gjuhët e programeve të akredituara të studimit⁹. Universiteti organizon studimet në gjuhën shqipe dhe në gjuhët tjera zyrtare të Kosovës¹⁰. Me propozim të njëjësive akademike, ligjëratat mund të mbahen edhe në gjuhë të tjera, por për këtë duhet të vendos Senati¹¹.

Institucionet publike të arsimit të lartë sigurojnë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën të cilën kandidatët nga komunitetet e kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetëdeklarim¹². Provimi pranues ofrohet në gjuhën serbe, turke dhe boshnjake. Kandidatët nga komunitetet jo-shumicë, gjithashtu mund të pajisen me testet në gjuhën shqipe sipas formularit për vetëdeklarim të gjuhës preferenciale të kandidatit¹³.

⁵Neni 4, paragrafi 2, Ligji Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

⁶Neni 23, paragrafi 1, Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve.

⁷Neni 23, paragrafi 2 dhe 4, Ligji për përdorimin e gjuhëve.

⁸Neni 8, paragrafi 3, Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

⁹Neni 3, paragrafi 1, UA (MASH) NR. 09/2016 Aplikimi i mmasave Afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet jo-shumicë në Institucionet publike të arsimit të lartë.

¹⁰Neni 141, paragrafi 1, Statuti i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

¹¹Neni 141, paragrafi 2, po aty.

¹²Neni 3, paragrafi 2, UA (MASH) NR. 09/2016 Aplikimi i mmasave Afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komunitetet jo-shumicë në Institucionet publike të arsimit të lartë.

¹³Neni 3, paragrafi 3 dhe 4 po aty.

Masat afirmative për komunitetet jo-shumicë

Qeveria e Kosovës e ka obligim ligjor të sigurojë qasje të barabartë të personave që u përkasin komuniteteve në arsimin e lartë në nivelin universitar. Kjo bëhet duke krijuar masa të veçanta për të siguruar pranimin e kandidatëve që vijnë nga shkollat e komuniteteve në institucionet e arsimit të lartë dhe universitar¹⁴.

Në vitin 2016 është nxjerrë Udhëzimi Administrativ nr.09/2016 - Aplikimi i masave afirmative dhe vendeve të rezervuara për regjistrim të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë në institucionet publike të arsimit të lartë (tutje udhëzimi për masat afirmative dhe vendet e rezervuara). Ky udhëzim garanton:

- Aplikimin e masave afirmative për regjistrimin e kandidatëve nga komunitetet jo-shumicë në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, në nivel BA, MA dhe PhD;
- Përdorimin e gjuhës së komuniteteve;
- Caktimin e kuotës 12% për regjistrim të studentëve nga komunitetet jo-shumicë të numrit të përgjithshëm të studentëve për pranim;
- Mbështetjen financiare dhe lirim nga pagesa¹⁵;
- Rezervimi i vendeve në konvikte dhe mensat studentore për studentët e komuniteteve jo-shumicë, 12% nga numri i përgjithshëm.

¹⁴Neni 8, paragrafi 11, Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

¹⁵Students from non-majority communities are beneficiaries of scholarship schemes and financial support. Whereas, students who are beneficiaries of social assistance schemes are exempted from paying the semester, accommodation in dormitories and food in the canteen.

STUDENTËT E KOMUNITETEVE JO-SHUMICË NË FAKULTETET E UP-SË

Qëllimi i këtij publikimi është që të ofrojë një pasqyrë të masave afirmative për komunitetet jo-shumicë, efektin e tyre ndër vite dhe propozimin e politikave në favor të shkollimit të komuniteteve pakicë në UP. Hulumtimi synon të ofrojë një përmbledhje të detajuar të trendeve të studimit për studentët e komuniteteve jo-shumicë, duke përfshirë fakultetet me interesimin më të lartë dhe më të ulët të studentëve për të vijuar studimet, fakultetet me përmbushjen më të madhe të vendeve të rezervuara, fakultetet me numrin më të madh të të diplomuarve në raport me numrin e të pranuarve, e me radhë.

Po ashtu, hulumtimi synon të tregojë se cili është efekti i kuotave dhe faktorëve të tjerë, siç janë njohja e gjuhës shqipe, kushtet e dobëta ekonomike dhe faktorë të tjerë në përfshirjen apo mospërfshirjen e të rinjve të komuniteteve jo-shumicë në UP. Më konkretisht, do të sqarojë se çka tregojnë numrat e arsimit të komuniteteve në UP ndër vite, t'i shpjegojë shkaktarët e këtyre rezultateve, qofshin kushtet ekonomike, mungesa e njohjes së avansuar të shqipes apo mungesa e interesimit apo arsye krejt të tjera.

Prandaj, hulumtuam pasqyrat e numrave të studentëve të komuniteteve jo-shumicë në të gjitha fakultetet e UP-së të regjistruar nëpër vitet akademike në BA, për ta evidentuar interesimin e tyre për të vijuar studimet gjatë periudhës 2008-2020, përmbushjen e kuotave dhe diplomimet. Po ashtu, zhvilluam intervista me sekretarin e UP-së, menaxhmentet e fakulteteve dhe zyrtarin për informim të Qendres së Studentëve, si dhe me përfaqësues nga MASH dhe AKA.

Fakultetet



FAKULTETI I ARTEVE

Në periudhën 2008-2020 kanë qenë gjithsejt 155 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë janë pranuar vetëm 24 studentë të këtyre komuniteteve (1 serb, 3 RAE, 1 goran, 7 turq, 12 boshnjakë), që i bie 15.5% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 14 ose 58% e studentëve të pranuar (5 RAE, 6 turq, 3 boshnjakë).

Fakulteti i Arteve - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite			
VITI AKADEMIK	VENDET E REZERVUARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	4	0	0
2009 - 2010	7	2	0
2010 - 2011	8	2	0
2011 - 2012	8	0	1
2012 - 2013	8	1	2
2013 - 2014	8	0	2
2014 - 2015	13	2	1
2015 - 2016	19	0	4
2016 - 2017	21	5	1
2017 - 2018	20	2	1
2018 - 2019	19	2	2
2019 - 2020	20	8	0
Gjithsej	155	24	14

Dekani i Fakultetit të Arteve, Agim Selimi, thotë se në vitin 2019 kemi pasur problem për zbatimin e kuotës për pranimin e studentëve të komuniteteve jo-shumicë sepse kjo kuotë ka hyrë në kuadër të numrit total të studentëve. Kjo ka shkaktuar probleme, meqë edhe ashtu Fakulteti i Arteve pranon numër të vogël të studentëve. Për këtë, dekani Selimi shton se kanë bërë kërkesë, e cila është aprovuar nga Senati i UP-së, për plotësimin e vendeve të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë, me studentë të komunitetit shumicë, por kjo nuk është lejuar nga MASH-i. Sipas dekanit Selimi, numri i përgjithshëm për pranimin e studentëve nuk duhet të preket asses nga kuota. Po ashtu, dekani Selimi tregon se nuk ka pasur raportime për pengesa sa i përket gjuhës, nga ana e studentëve të komuniteteve jo-shumicë.

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 361 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 18 studentë të këtyre komuniteteve (2 RAE, 1 goran, 5 turq, 10 boshnjakë), që i bie 4.98% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 4 ose 22.22% e studentëve të pranuar (1 turk, 3 boshnjakë). Fakulteteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë prin me numrin më të lartë të vendeve të mbetura të zbrazëta nga vendet e rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë.

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite

VITI AKADEMIK	VENDET E REZERVUARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	5	0	0
2009 - 2010	9	0	0
2010 - 2011	9	0	0
2011 - 2012	10	0	0
2012 - 2013	13	0	1
2013 - 2014	13	0	0
2014 - 2015	22	0	0
2015 - 2016	19	3	0
2016 - 2017	68	6	0
2017 - 2018	64	7	0
2018 - 2019	64	1	2
2019 - 2020	65	1	1
Gjithsej	361	18	4

Ushtryesi i Detyrës së Dekanit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Imer Rusinovci, thotë se interesimi i studentëve të komuniteteve jo-shumicë për të vijuar studimet në këtë fakultet është i vogël, e vendet që mbesin të zbrazëta paraqesin problem, veçanërisht në nivelin MA të studimeve. Sipas tij, kuota për pranimin e studentëve të komuniteteve jo-shumicë duhet të jetë e ndarë dhe të mos përfshihet në kuadër të numrit total të studentëve. Dekani Rusinovci thotë se nuk ka pasur raste kur gjuha ka qenë pengesë për studentët, ndërsa duhet theksuar se provimi pranues përkthehet në gjuhën amtare të aplikantëve sipas kërkesës.

FAKULTETI I EDUKIMIT

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 295 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 59 studentë të këtyre komuniteteve (asnjë sërb, 36 RAE, asnjë goranë, 18 turq, 5 boshnjakë), që i bie 20% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 14 ose 23.78% e studentëve të pranuar (1 RAE, 4 turq, 9 boshnjakë).

Fakulteti i Edukimit - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite			
VITI AKADEMIK	VENDET E REZERVUARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	13	1	0
2009 - 2010	14	8	0
2010 - 2011	15	0	0
2011 - 2012	16	1	1
2012 - 2013	23	6	1
2013 - 2014	23	0	2
2014 - 2015	37	10	2
2015 - 2016	25	0	0
2016 - 2017	49	10	2
2017 - 2018	27	7	3
2018 - 2019	22	7	2
2019 - 2020	31	9	1
Gjithsej	295	59	14

Ndonëse menaxhmenti i kaluar i Fakultetit të Edukimit nuk është përgjigjur në kërkesën tonë për qasje në dokumente e të dhëna publike, e as në kërkesën për intervistë, menaxhmenti i ri na ofroi të dhëna pa hezitim. Dekani Blerim Saqipi thotë se shkaktarët kryesor për numrin e vogël të pranimit të studentëve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë mund të jenë mosinteresimi i tyre për të vijuar studimet universitare, sukcesi i dobët paraprak dhe i cili mund t'i penajzojë, vështirësitë për të kaluar pragun e kalueshmërisë, e në disa raste edhe mosinteresimi për të aplikuar në kuadër të kuotave të rezervuara.

Sa i përket numrit të vogël të të diplomuarve, dekani Saqipi tregon se nuk ka pasur ankesa nga ana e studentëve të komuniteteve jo-shumicë në lidhje me vështirësi apo pengesa eventuale që mund të jenë shkaktuar nga stafi akademik ose administrativ. Ndërkaq, dekani Saqipi shton se mungesa e vetmotivimit të studentëve mund të jetë arsyeja kryesore për numrin e vogël të të diplomuarve. Po ashtu, dekani Saqipi thotë se pengesat në gjuhë mund të jenë një faktor për mosvijimin e rregullt të studimeve, pavarësisht se profesorët të cilët njohin gjuhën e komuniteteve ua mundësojnë studentëve të përgjigjen në atë gjuhë.

FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 157 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 38 studentë të këtyre komuniteteve (3 RAE, 2 goranë, 11 turq, 22 boshnjakë), që i bie 24.20% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 14 ose 36.84% e studentëve të pranuar (5 turq, 9 boshnjakë). Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit bën pjesë në pesë fakultetet me përmbushjen më të madhe të vendeve të rezervuara për komunitetet jo-shumicë, si dhe me numrim më të madh të të diplomuarve në raport me të pranuarve.

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite			
VITI AKADEMIK	VENDET E REZERVUARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	3	1	0
2009 - 2010	8	1	0
2010 - 2011	8	2	0
2011 - 2012	12	1	0
2012 - 2013	11	0	1
2013 - 2014	11	2	1
2014 - 2015	21	9	2
2015 - 2016	14	1	2
2016 - 2017	18	7	2
2017 - 2018	18	5	0
2018 - 2019	15	8	6
2019 - 2020	18	1	0
Gjithsej	157	38	14

Dekani i Fakulteti të Edukimit Fizik dhe Sportit, Musa Selimi, thotë se nuk është korrekte që vendet e rezervuara të cilat mbasin të zbrazëta, të mos plotësohen me studentë të komunitetit shumicë. Sipas tij, kuota për pranimin e studentëve të komuniteteve jo-shumicë duhet të zvogëlohet, por nëse kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të plotësohet me studentë të tjerë dhe të mos përjashtohen studentët shqiptarë nga e drejta e tyre për studim.

Dekani Selimi sqaron se numri i vogël i studentëve të pranuar nga komunitetet jo-shumicë, vjen nga numri i vogël i aplikantëve nga komunitetet si dhe nga mospërmbushja e kriterëve që kërkohen. Kurse shkaktar për numrin e vogël të të diplomuarve konsiderohet që është braktisja e studimeve, kryesisht për shkak të migrimit. Thënë këtë, duhet theksuar se fakulteti nuk ka të dhëna për shkallën e braktisjes së studimeve nga studentët e komuniteteve jo-shumicë. Po ashtu, dekani Selimi tregon se në rastet kur ka pasur raportime për pengesa në gjuhë nga ana e studentëve të komuniteteve jo-shumicë, atyre u është sugjeruar që të komunikojnë më shumë me shokët e gjeneratës.

FAKULTETI I EKONOMISË

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 1060 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 128 studentë të këtyre komuniteteve (25 RAE, 2 goranë, 58 turq, 43 boshnjakë), që i bie 12.07% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 11 ose 8.59% e studentëve të pranuar (3 RAE, 3 turq, 5 boshnjakë). Një veçanti e Fakultetit të Ekonomisë është se ka numrin më të lartë të të diplomuarve nga radhët e komunitetit rom. Kurse pavarësisht se prin me numrin më të lartë të vendeve të rezervuara në UP, përmbushja e kuotës është e vogël.

Fakulteti i Ekonomisë - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite			
VITI AKADEMIK	VENDET E REZERVUARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	18	12	0
2009 - 2010	21	23	0
2010 - 2011	27	22	0
2011 - 2012	27	19	0
2012 - 2013	33	11	1
2013 - 2014	33	4	1
2014 - 2015	41	8	1
2015 - 2016	29	2	3
2016 - 2017	209	11	3
2017 - 2018	198	6	0
2018 - 2019	196	5	2
2019 - 2020	228	4	0
Gjithsej	1060	128	11

Menaxhmenti i Fakultetit të Ekonomisë na ofroi pa hezitim qasje në të dhënat e kërkuara, kurse nuk u përgjigj në kërkesën tonë për të zhvilluar intervistë lidhur me temën e këtij hulumtimi.

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 469 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 121 studentë të këtyre komuniteteve (16 RAE, 2 goranë, 47 turq, 56 boshnjakë), që i bie 25.79% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 88 ose 72.72 % e studentëve të pranuar (4 RAE, 77 turq, 7 boshnjakë).

Fakulteti i Filologjisë - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite			
VITI AKADEMIK	VENDET E PARAPARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	10	5	0
2009 - 2010	13	14	2
2010 - 2011	12	6	2
2011 - 2012	17	7	9
2012 - 2013	24	11	2
2013 - 2014	24	8	12
2014 - 2015	48	11	6
2015 - 2016	33	2	19
2016 - 2017	79	18	15
2017 - 2018	70	18	12
2018 - 2019	62	10	8
2019 - 2020	77	10	0
Gjithsej	469	121	88

Dekanja e Fakultetit të Filologjisë, Lindita Sejdiu-Rugovën, tregon se departamentet me interesimin më të lartë të studentëve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë janë gjuha angleze, gjuha gjermane, gjuha turke dhe orientalistika. E megjithatë, përveç në vitin akademik 2009/10, asnjëherë nuk janë plotësuar vendet e rezervuara. Sipas dekanes Sejdiu-Rugova, kuota për pranimin e studentëve të komuniteteve jo-shumicë duhet të jetë e ndarë dhe të mos përfshihet në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve. Si opcion, ajo shton, është të mos ketë kuota fare për shkak se kandidatet duhet të konkurrojnë në garë të barabartë me të gjithë.

Po ashtu, dekanja Sejdiu-Rugova tregon se nuk ka pasur raportime për pengesa sa i përket gjuhës, nga ana e studentëve të komuniteteve jo-shumicë. Një e veçantë e këtij fakulteti është se ka pasur programin BA Ballkanistika, drejtim shkencor, që synonte të përgatiste mësimdhënës të gjuhëve të Ballkanit, përkthyes, këshilltarë dhe ambasadorë të ardhshëm. Në kuadër të këtij programi do të mësoheshin gjuhët ballkanike, ndërsa lëndët teorike do të ligjroheshin në gjuhën angleze. Programi zgjati vetëm një vit dhe nuk u riakreditua për shkak se nuk kishte bartës. Ndërsa përmes këtij programi, janë realizuar shumë marrëveshje bashkëpunimi ERASMUS + dhe si nismë e mësimit të kroatishtes në Prishtinë dhe shqipes në Zagreb, është nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi në mes të Ministrive të Arsimit të Kosovës dhe të Kroacisë për shkëmbimin e studentëve dhe të profesorëve, që pritet të zbatohet në praktikë.

FAKULTETI I FILOZOFISË

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 476 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 120 studentë të këtyre komuniteteve (42 RAE, 37 turq, 40 boshnjakë, 1 kroat), që i bie 25.21% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 47 ose 39.16% e studentëve të pranuar (1 rom, 4 ashkalinjë, 1 goran, 12 turq, 29 boshnjakë).

Fakulteti i Filozofisë - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndë vite			
VITI AKADEMIK	VENDET E PARAPARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	13	3	0
2009 - 2010	13	6	0
2010 - 2011	16	11	0
2011 - 2012	21	7	1
2012 - 2013	25	10	3
2013 - 2014	25	13	7
2014 - 2015	50	9	10
2015 - 2016	22	7	7
2016 - 2017	76	24	4
2017 - 2018	76	13	8
2018 - 2019	67	11	5
2019 - 2020	72	6	2
Gjithsej	476	120	47

Menaxhmenti i Fakultetit të Filozofisë na ofroi pa hezitim qasje në të dhënat e kërkuara, kurse për shkak të angazhimeve të shumta e patën të pamundur që të zhvillonin një intervistë lidhur me temën e këtij hulumtimi.

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 340 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 68 studentë të këtyre komuniteteve (9 RAE, 19 turq, 40 boshnjakë), që i bie 20% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 10 ose 14.7% e studentëve të pranuar (2 romë, 4 turq, 4 boshnjakë).

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite

VITI AKADEMIK	VENDET E REZERVUARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	4	2	0
2009 - 2010	6	3	0
2010 - 2011	10	8	0
2011 - 2012	22	5	0
2012 - 2013	27	3	0
2013 - 2014	27	7	0
2014 - 2015	41	11	0
2015 - 2016	27	0	0
2016 - 2017	43	7	1
2017 - 2018	45	4	6
2018 - 2019	43	5	2
2019 - 2020	45	8	0
Gjithsej	340	68	9

Për shkak se Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (FNA) është ndarë në dy njësi akademike para dy vitesh - në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe në Fakultetin e Arkitekturës - zhvilluam intervista me Dekanin Fevzi Berisha (FA) dhe me Dekanin Avdullah Zejnullahu (FN). Të dy dekanët shprehën shqetësim për zvogëlimin e numrit për pranimin e studentëve shqiptarë si pasojë e përfshirjes së vendeve të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve. Sipas tyre, kuota për pranimin e studentëve të komuniteteve jo-shumicë duhet të jetë e ndarë nga numri total për pranimin e studentëve, në mënyrë që fakulteti të mund të operojë me kapacitete të plota.

Dekanët e këtyre fakulteteve shprehen se nuk ka pasur ankesa për vështirësi sa i përket gjuhës për studentët e komuniteteve jo-shumicë dhe shtojnë se po të ketë, do të jenë të gatshëm të ofrojnë mbështetje. Megjithatë, sipas dekanit Zejnullahu, fakti që asnjëherë nuk është plotësuar kuota për pranimin e studentëve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë në UP është indikator se diçka nuk është në rregull. Sipas dekanit Fevzi Berisha, në mënyrë që të rritet vijueshmëria e studentëve të këtyre komuniteteve duhet që të punohet më shumë gjatë shkollës së mesme në përgatitjen e tyre për pritshmëritë dhe kërkesat e studimeve universitare.

Fakulteti i Ndërtimtarisë nuk ka të dhëna të sakta dhe të sigurta lidhur me shkallën dhe arsyet e braktisjes së studimeve nga ana studentëve të komuniteteve jo-shumicë. Te Fakulteti i Arkitekturës, një nga shkaktarët e numrit të vogël të të diplomuarve, konsiderohet se mund të jenë kriteret më të larta të pranimin dhe fakti se programi studimor kërkon angazhim më të veçuar. Kurse, nuk ka të dhëna për shkallën e braktisjes së studimeve nga studentët e komuniteteve jo-shumicë.

FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 360 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 48 studentë të këtyre komuniteteve (6 RAE, 10 turq, 32 boshnjakë), që i bie 13.33% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 3 ose 6.25% e studentëve të pranuar (1 turq, 2 boshnjakë).

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite

VITI AKADEMIK	VENDET E REZERVUARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	13	1	0
2009 - 2010	13	2	0
2010 - 2011	15	2	0
2011 - 2012	15	1	0
2012 - 2013	19	7	1
2013 - 2014	19	12	1
2014 - 2015	34	7	1
2015 - 2016	24	3	1
2016 - 2017	55	6	0
2017 - 2018	55	2	0
2018 - 2019	51	5	0
2019 - 2020	47		0
Gjithsej	360	48	3

Prodekanja e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Mimoza Ibrani, thotë se interesimi nga komunitetet jo-shumicë ka qenë shumë i vogël dhe se asnjëherë nuk janë përmbushë kuotat e parapara. Për këtë, Dekani Isak Shabani thotë se numri i vogël i studentëve të pranuar lidhet me interesimin e vogël të aplikantëve për të studiuar në programet që ofrohen në këtë fakultet. Ai shton se shkak për mospërmbushjen e kuotës është numri i vogël i aplikantëve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë, pavarësisht se pragu i kalueshmërisë është 10% më i ulë se për studentët e komunitet shumicë.

Në këtë fakultet ka vetëm studentë të komunitetit turk, boshnjak dhe egjiptian, kurse inxhinieria kompjuterike është departamenti me interesimin më të lartë nga këto komunitete. Ndonëse provimi pranues përkthehet në gjuhën e komuniteteve sipas kërkesës, ligjëratat janë në gjuhën shqipe, dhe kjo paraqet pengesë gjatë studimeve për këto komunitete. Sipas prodekanës Ibrani, barriera kryesore për mos-vijimin dhe mos-përfundimin e studimeve është gjuha e studimeve, e për këtë sugjeron organizimin e kurseve të gjuhës shqipe në kuadër të universitetit. Po ashtu, duhet theksuar se fakulteti nuk ka të dhëna për shkallën e braktisjes së studimeve nga studentët e komuniteteve jo-shumicë.

FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 301 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 20 studentë të këtyre komuniteteve (8 RAE, 2 turq, 10 boshnjakë), që i bie 6.64% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 1 ose 5% e studentëve të pranuar (1 boshnjak). FIM është fakulteti në të cilin më së paku janë plotësuar vendet e rezervuara si dhe ka numrin më të vogël të të diplomuarve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë.

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite			
VITI AKADEMIK	VENDET E PARAPARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	1	0	0
2009 - 2010	-	-	0
2010 - 2011	3	1	0
2011 - 2012	7	0	0
2012 - 2013	11	0	0
2013 - 2014	11	3	0
2014 - 2015	15	1	0
2015 - 2016	19	0	0
2016 - 2017	60	8	0
2017 - 2018	55	3	0
2018 - 2019	66	-	1
2019 - 2020	53	4	0
Gjithsej	301	20	1

Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Ahmet Shala, thotë se zbatimi i kuotës për pranimin e studentëve të komuniteteve jo-shumicë, vitin e kaluar ka prekur numrin e përgjithshëm për pranimin e studentëve. Për rrjedhojë, vendet e zbrazëta janë plotësuar me studentë të komunitetit shumicë, pavarësisht se ka pasur probleme për t'i regjistruar në sistemin SMIAL. Sipas dekanit Shala, përfshirja e kuotës për minoritete në kuadër të numrit të përgjithëm është në kundërshtim me vet akreditimin.

Ai sqaron se kjo sjellë probleme, veçanërisht në programet ku konkurenca është më e madhe, dhe shton se duhet të ketë një vendim të bashkërenduar në mes AKA-së dhe MASH-it. Shkollimi paraprak dhe mungesa e shkollave përkatëse profesionale në gjuhë të komuniteteve janë shkaktarët kryesor për numrin e vogël të studentëve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë, sipas Dekanit Shala. Përveç kësaj, ai sqaron se profilet e inxhinierisë cilësohen si studime që kërkojnë më shumë angazhim përgjithësisht, e për rrjedhojë, mund të përceptohen si më të vështira edhe nga ana e studentëve të komuniteteve jo-shumicë. Kurse migrimi, braktisja, mospërshtatja e profesionit të zgjedhur, shihen si arsye e numrit të vogël të të diplomuarve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë. Po ashtu, dekani Shala tregon se nuk ka pasur raportime për pengesa sa i përket gjuhës, nga ana e studentëve të komuniteteve jo-shumicë.

FAKULTETI JURIDIK

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 591 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 113 studentë të këtyre komuniteteve (36 RAE, 41 turq, 36 boshnjakë), që i bie 19.12% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 13 ose 11.5 % e studentëve të pranuar (2 RAE, 1 turk, 9 boshnjakë, 1 kroat).

Fakulteti Juridik - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite			
VITI AKADEMIK	VENDET E PARAPARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	15	5	0
2009 - 2010	18	17	0
2010 - 2011	21	10	0
2011 - 2012	22	12	0
2012 - 2013	27	10	1
2013 - 2014	27	11	0
2014 - 2015	42	14	0
2015 - 2016	28	5	2
2016 - 2017	108	10	4
2017 - 2018	96	8	2
2018 - 2019	91	7	4
2019 - 2020	96	4	0
Gjithsej	591	113	13

Dekani i Fakultetit Juridik, Haxhi Gashi, thotë se është i shqetësuar me mosplotësimin e vendeve të zbrazëta. Sipas tij, kuota për pranimin e studentëve nga radhët e komuniteteve jo-shumicë duhet të jetë e ndarë nga numri i përgjithshëm. Sa i përket masave afirmative, dekani Gashi thotë se duhet të punohet më shumë për përfshirjen e studentëve të komuniteteve jo-shumicë, mirëpo sa i përket pragut të kalueshmërisë, ai shton se duhet të jetë i njëjtë për të gjithë për shkak se ata do të konkurojnë në tregun e njëjtë të punës. Lidhur me këtë, ai thotë se ulja e pragut të kalueshmërisë ka ndikuar vetëm në pranimin më të lehtë të aplikantëve, por jo në rritjen e numrit të aplikantëve.

Si shkak për numrin e vogël të aplikuesve konsiderohet ndërprerja e shkollimit në fazat paraprake. Sipas sekretarit të Fakultetit Juridik, Miftar Shala, braktisja e studimeve për shkak të gjendjes ekonomike të vështirë, është shkak i numrit të vogël së studentëve të diplomuar nga ky fakultet. Ndërkaq, sekretari sqaron se administrata e këtij fakulteti nuk ka sistem të mbajtjes së të dhënave për shkallën e braktisjes së studimeve nga studentët e komuniteteve jo-shumicë. Sa i përket gjuhës së studimeve, dekani Gashi tregon ka pasur njoftime nga ana e studentëve të komuniteteve jo-shumicë për vështirësi sa i përket gjuhës, kryesisht studentë të komunitetit boshnjak, dhe në këto raste janë marrë masat e nevojshme për t'i akomoduar nevojat e tyre. Dekani sqaron se ligjeratat janë ofruar në gjuhën shqipe, kurse në kohën e vlerësimeve janë pyetur në gjuhën e tyre dhe janë trajtuar në mënyrë të veçantë.

FAKULTETI I MJEKËSISË

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 409 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 206 studentë të këtyre komuniteteve (44 RAE, 2 goranë, 73 turq, 86 boshnjakë, 1 kroat), që i bie 50.36% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 9 ose 4.36% e studentëve të pranuar (1 egjiptian, 4 turq, 4 boshnjakë). Ndonëse Fakulteti Mjekësisë prin me plotësimin më të madh të vendeve të rezervuara, ka numrin më të ulët të studentëve të diplomuar nga radhët e komuniteteve jo-shumicë (4.36%).

Fakulteti i Mjekësisë - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite			
VITI AKADEMIK	VENDET E PARAPARA	TË PRANUAR	TË DIPLOMUAR
2008 - 2009	22	22	0
2009 - 2010	28	10	0
2010 - 2011	39	13	0
2011 - 2012	31	9	0
2012 - 2013	25	13	2
2013 - 2014	25	10	2
2014 - 2015	50	22	1
2015 - 2016	26	10	0
2016 - 2017	44	16	3
2017 - 2018	44	15	0
2018 - 2019	31	31	1
2019 - 2020	44	36	0
Gjithsej	409	206	9

Dekanja e Fakultetit të Mjekësisë, Suzana Manxhuka-Kërliu, thotë se ka pasur reagime nga dekanët e fakulteteve të UP-së lidhur me kuotën për pranimin e studentëve të komuniteteve jo-shumicë, e që sipas saj është e lartë. Ajo sqaron se për shkak se pragu i kalueshmërisë ka qenë dhe është më i ulët për studentët e komuniteteve jo-shumicë, në të kaluarën ka pasur keqpërdorime ngaqë nuk ka ekzistuar një mekanizëm praktik për përcaktimin e nacionalitetit/etnisë.

Tutje, dekanja Manxhuka-Kërliu tregon se vendet e rezervuara që kanë mbetur të zbrazëta nuk janë plotësuar, por shton se kuota për studentët e komuniteteve jo-shumicë duhet të jetë e ndarë nga numri i përgjithshëm për pranimin e studentëve për shkak se konkurrenca është shumë e madhe. Sipas dekanës Manxhuka-Kërliu, shkak kryesor për mospërmbushjen e kuotës është arritshmëria e pamjaftueshme në provimin pranues. Ndërsa, shkak për numrin e vogël të të diplomuarve është mospërmbushja e obligimeve ndaj institucionit, siç janë vijueshmëria në ligjerata dhe ushtrime, të cilat janë obligative dhe kriter i përgjithshëm për të gjitha komunitetet. Pastaj janë edhe pengesat gjuhësore, njohuritë bazë nga shkollimi paraprak dhe kushtet ekonomike. Po ashtu, dekanja Manxhuka-Kërliu pohon se nuk ka pasur ankesa për vështirësi sa i përket gjuhës. Për fund, ajo thotë se studentët e komuniteteve jo-shumicë janë mjaftueshëm të përfshirë në raport me numrin si dhe kanë kritere më të ulëta. Sipas dekanës Manxhuka-Kërliu, kriteret duhet të jenë të njëjta për të gjithë për shkak dhe për këtë duhet që patjetër të investohet më tepër në arsimin parauniversitar. Duhet theksuar se fakulteti nuk ka sistem të veçantë të mbajtjes së të dhënave mbi shkallën e braktisjes së studimeve nga studentët e komuniteteve jo-shumicë

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKO-NATYRORE

Në periudhën 2008-2020 gjithsejt kanë qenë 398 vende të rezervuara për studentë të komuniteteve jo-shumicë. Mirëpo, në këtë periudhë, janë pranuar vetëm 27 studentë të këtyre komuniteteve (2 RAE, 4 goranë, 5 turq, 16 boshnjakë), që i bie 6.78% e vendeve të rezervuara. Prej tyre kanë diplomuar vetëm 10 ose 37.03% e studentëve të pranuar (1 rom, 1 turk, 7 boshnjakë, 1 kroat).

Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore - numri i vendeve të rezervuara, i të pranuarve dhe i të diplomuarve ndër vite			
ACADEMIC YEAR	RESERVED PLACES	ENROLLED	GRADUATED
2008 - 2009	6	2	0
2009 - 2010	7	0	0
2010 - 2011	10	1	0
2011 - 2012	16	1	0
2012 - 2013	19	0	1
2013 - 2014	19	0	1
2014 - 2015	30	0	2
2015 - 2016	26	1	5
2016 - 2017	74	5	1
2017 - 2018	68	12	0
2018 - 2019	65	4	0
2019 - 2020	58	1	0
Gjithsej	398	27	10

Dekani i Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore, Tahir Arbnesi, thotë se interesimi i studentëve të komuniteteve jo-shumicë për të vijuar studimet në këtë fakultet është i vogël, por edhe një pjesë e madhe e atyre që aplikojnë nuk mund të kalojë prap. Ai tregon se për këtë arsye është shpallur për herë të tretë afat për plotësimin e vendeve të zbrazëta, por prap nuk vshhtë kaluar pragu. Sipas tij, numri i përgjithshëm për pranimin e studentëve nuk duhet të preket assesi nga kuota. Miërpo, shton se për integrim sa më të lehtë, studentët e komuniteteve jo-shumicë duhet të jenë në gjendje t'i ndjekin ligjeratat aktivisht. Për këtë, ai thotë se do të ishte ideale që secili departament të ketë një program në gjuhën angleze. Po ashtu, dekani tregon se nuk ka pasur raportime për pengesa sa i përket gjuhës, përveç një rast në nivelin master të studimeve që ka kërkuar që temën e diplomës ta përgatis në gjuhën boshnjake, gjë që i është mundur.

**QËNDRIME TË INSTITUCIONEVE
RELEVANTE LIDHUR ME
PËRFSHIRJEN E STUDENTËVE
TË KOMUNITETEVE NË UP**



QËNDRIME TË INSTITUCIONEVE RELEVANTE LIDHUR ME PËRFSHIRJEN E KOMUNITETEVE NË UP

Për nevojat e këtij hulumtimi, përveç intervistave të zhvilluara në nivel të njësisve akademike të UP-së, takuam dhe intervistuam zëvendësministrin e MASH-it, Xhavit Rexhaj, Drejtorin e AKA-së, Naim Gashin, Sekretarin e UP-së, Esat Kelmendin, dhe Zyrtaren për Informim të QS-së, Shyhrete Abdullahun. Në këtë kapitull, të ndara në tematika, janë përmbledhë qëndrimet e përfaqësuesve të insitucioneve relevante.

Kuotat për komunitetet jo-shumicë para pavarësisë

Sa i përket praktikës së rezervimit të vendeve për komunitetet jo-shumicë para Shpalljes së Pavarësisë, në UP kuotat kanë filluar të zbatohen diku nga viti 2004-2005. Njëjtë, edhe Qendra e Studentëve, para Udhëzimit Administrativ¹⁶, (tutje UA Nr. 09/2016), përmes të cilit sigurohet 12% e vendeve për komunitetet jo-shumicë, ka pasur studentë të komuniteteve që ishin banues aty. Vlerësohet se vendosja e studentëve nga komunitetet në konvikte dhe mensë ka filluar qysh nga viti 1999, për të krijuar mundësi të barabarta në studime dhe integrim në shoqërinë Kosovare. Nga 2008 deri në vitin 2019, pjesëtarë për banim dhe ushqim kanë qenë gjithsej mbi 900 studentë nga radha e komuniteteve jo-shumicë.

Masat afirmative lidhur me vendet e rezervuara

